



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 12 mars 2013

Nr. ref.:RK393/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Në

Rasti nr. KI 10/13

Parashtruesi

Enver Zeneli

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme

Pkl.nr.125/2012,

i datës 30 nëntor 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

Kërkesa

1. Kërkesa është parashtruar nga Enver Zeneli, me banim në fshatin Malishevë, Komuna e Gjilanit (më tej në tekst: Parashtruesi), përfaqësuar me autorizim nga Z. Shemsedin Piraj.
2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pkl.nr.125/2012, të datës 30 nëntor 2012 (më tej në tekst: Aktgjykimi).
3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit, si dhe Rregullat 30 dhe 75 të Rregullores.

Procedura në Gjykatë

4. Më 25 janar 2013, Parashtruesi ka dorëzuar Kërkesën e tij në Gjykatë.
5. Më 3 shkurt 2012, Kryetari emëroi Gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar Raportues, si dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët Altay Suroy (Kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
6. Më 27 shkurt 2013, Gjykata informoi Gjykatën Supreme të Kosovës për Kërkesën.
7. Më 27 shkurt 2013, Gjykata i dërgoi letër Parashtruesit, duke i kërkuar atij të plotësojë formularin zyrtar të kërkesës, si dhe të bashkëngjese edhe autorizimin e avokatit të tij.
8. Më 4 mars 2013, avokati i Parashtruesit dorëzoi dokumentet e kërkuara shtesë.
9. Më 12 mars, 2013, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmeri të kërkesës, dhe të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 6 prill 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë e shpalli (P.nr.210/2005) Parashtruesin fajtor për akuzën e vjedhjes së rëndë [neni 253 i KPK-së] dhe falsifikimin e dokumenteve [neni 332 i KPK-së] si dhe e dënoi atë me 6 muaj burgim dhe gjobë prej 1000 € (një mijë Euro).

11. Më 17 qershor 2006, Parashtruesi bëri ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër atij Aktgjykimit, duke e kontestuar atë, me propozim të anulimit të aktgjykimit dhe rigjykimit të tij.
12. Më 21 nëntor 2008, Gjykata e Qarkut pjesërisht aprovoi (AP.nr.452/06) ankesën e Parashtruesit, si dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, duke e konfirmuar burgimin për gjashtë (6) muaj, si dhe duke ndryshuar shumën e gjobës nga 1000 € (njëmijë euro) në 800 (tetëqind euro).
13. Më 13 korrik 2012, Parashtruesi dorëzoi në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse «unë si i akuzuar nuk kam mundur të paraqes mbrojtjen time, pra e drejta ime për t'u mbrojtur në këtë fazë të procedurës është shkelur, si dhe ka qenë e rëndësishme për dhënien e një aktgjykimi të drejtë dhe ligjor».
14. Më 22 mars 2010, Gjykata Supreme e shpalli (Pkl.nr.15/2010) kërkesën të bazuar, si dhe anuloi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, si dhe obligoi rigjykimin e rastit, pasi që Gjykata e Qarkut në Prishtinë kishte shkelur dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që rregullojnë pjesëmarrjen e palëve në seanca gjyqësore.
15. Më 6 maj 2010, Gjykata e Qarkut hodhi poshtë (Ap.nr.152/2010) ankesën e Parashtruesit, si dhe konfirmoi aktgjykimin (P.nr.210/2005) e Gjykatës Komunale.
16. Më 13 korrik 2012, Parashtruesi edhe një herë i kërkoi Gjykatës Supreme mbrojtjen e ligjshmërisë.
17. Më 30 nëntor 2012, Gjykata Supreme e hodhi poshtë (Pkl.no.125/2012), kërkesën si të pabazuar, duke theksuar që:

“...shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale që janë pohuar nuk janë të bazuara, siç theksohet në arsyetimin e këtij aktgjykimi, dispozitivi është i kuptueshëm i qartë dhe nuk ka kundërthënie me vetveten apo me arsyetimin”.

Pretendimet e Parashtruesit

18. Parashtruesi pretendon që *“gjykata e shkallës së parë, për arsye të panjohura për mua, i ka hequr vetes mundësinë që në këtë rast, të vlerësojë gjendjen faktike që prej krahasimit të mundshëm të këtyre të dhënave të këtyre dy mjeteve, do të mund të arrinte lehtësisht tek përfundimi që kemi të bëjmë me dy mjete që janë tërësisht të ndryshme në kuptimin e të dhënave të tyre teknike...”*.

19. Përveç kësaj, Parashtruesi pretendon që *“në mungesë të ofrimit të provave të propozuara materiale nga eksperti i fushës përkatëse – makinerisë, ekspertizë që është propozuar nga përfaqësuesi i mbrojtjes, gjendja faktike nuk është vërtetuar”*.
20. Në përgjithësi, Parashtruesi ankohet që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës.
21. Parashtruesi përfundon duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të nxjerrë një aktgjykim i cili do të:

“SHPALLËtë pranueshme kërkesën e parashtruesit Enver Zeneli nga fshati Malisheva, Komuna e Gjilanit.

HEDHË POSHTË gjitha vendimet e gjykatës dhe të kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

REKOMANDOJË gjykatës së shkallës së parë që të sigurojë provat e nevojshme materiale nga ekspertiza e një eksperti të fushës përkatëse – makineria, e cila është propozuar nga avokati i mbrojtjes dhe parashtruesi i kësaj kërkesë”.

22. Parashtruesi më tutje kërkon, edhe pse jo shprehimisht, nga Gjykata Kushtetuese që të vendosë masën e përkohshme në rastin e tij, duke kërkuar që:

“TË URDHËROJË ndalimin e ekzekutimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës sëparë në Prishtinë, identifikuar në shkresa”.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së Kërkesës

23. Më së pari, Gjykata vlerëson nëse Parashtruesi ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë të caktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe Rregullore.
24. Gjykata vëren se Parashtruesi ka argumentuar kërkesën me fakte të cilat i konsideron relevante dhe një referencë të nënkuptuar ndaj shkeljes së pohuar; shprehimisht kontestohet Aktgjykimi si akt konkret i autoritetit publik që i nënshtrohet shqyrtimit; thekson zgjidhjen e kërkuar; si dhe përmban vendimet e ndryshme dhe informatat e dokumentet tjera përkatëse.
25. Megjithatë, Gjykata vëren që Rregulli 36 (1).c) i Rregullores së Punës përcakton që:

“Gjykata mund të merret me Kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.”

26. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe palët e autorizuar] të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

27. Pretendimi kryesor i Parashtruesit ka të bëjë me pohimin për vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të provave materiale nga gjykatat e rregullta.
28. Gjykata rikujton që nuk është detyra e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet faktike apo ligjore (ligjshmërinë) që pohohen të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe deri në atë masë sa këto mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
29. Kështu, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të të drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
30. Pra, Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në plotësinë e tyre, janë ndërmarrë në atë mënyrë që t'i sigurojnë Parashtruesit gjykim të drejtë (shih, mes burimeve tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Ap. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
31. Për më tepër, Parashtruesi thjesht konteston faktin nëse Gjykata Supreme ka zbatuar plotësisht ligjin në fuqi, si dhe nuk pajtohet me gjetjet faktike të gjykatave në lidhje me rastin e tij.
32. Sa për faktet, Parashtruesi nuk ka vërtetuar pohimet e tij në baza kushtetuese, si dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë cenuar nga Gjykata Supreme.
33. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë që procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejtura apo të njollosura me arbitraritet (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e aplikacionit nr. 17064/06 të datës 30 qershor 2009).
34. Për më tepër, Gjykata thekson që aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Qarkut kanë qenë shumë mirë të argumentuara dhe thellësisht të

arsyetuara, si dhe rikujton edhe një herë që nuk i përket juridiksionit të vlerësimit të kushtetutshmërisë që të shqyrtojë vlerësimin e provave që bëhet nga gjykatat e rregullta.

35. Pra, rrjedh që në bazë të nenit 113 (1) të Kushtetutës, si dhe Rregullit 36 (1.c) të Rregullores, Kërkesa është e papranueshme dhe qartazi e pabazuar.

Kërkesa për masë të përkohshme

36. Neni 27 i Ligjit, si dhe në veçanti Rregulli 54 (1) i Rregullores së Punës, përcaktojnë që «në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës, si dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme».
37. Megjithatë, duke marrë parasysh që Kërkesa është shpallur e papranueshme, Parashtruesi nuk ka të drejtë, sipas Rregullit 54 (1) të Rregullores së Punës, që të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme.
38. Për më tepër, Parashtruesi thjesht kërkon nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme, pa ofruar ndonjë argument apo dokumente relevante shtesë që mbështesin kërkesën e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 27 të Ligjit dhe rregullin 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 12 mars 2013, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. TU KOMUNIKOJË këtë Vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;
- V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani